



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3173 prot.

Tiranë më, 04.12.2019

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 08, datë 04.12.2019

PËR

**GARANTIMIN E PAVARËSISË SË PROKURORIT, MARRËDHËNIET NDËRMJET
TIJ ME DREJTUESIT E PROKURORISË DHE INFORMIMIN NË PROKURORITË
ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje, të neneve 148, 148/b shkronja "b", "d", "dh" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 38 pikat 1 e 2 shkronjat "b", "d" e "f", 2 shkronjat "b" e "c", 4, 5, 6, 42 shkronja "a", "c" "g", 43, 46, 47, 48, 50 e vijues të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të neneve 24, 25 pika 2, 26, 27 pika 1 e vijues Kodit të Procedurës Penale, të nenit 52 e vijues të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të nenit 159 e vijues të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të nenit 132 e vijues të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë, dhe në aktet ndërkombëtare dhe evropiane të njohura e pranuar¹,

¹ Shih -Rekomandimet 19 (2000) date 6 Tetor 2000 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës "Mbi Rolin e Prokurorisë Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale", -pikat 9, 10, 36, faqe 21-22 dhe 34-35;

- Opinion nr. 9 (2014) datë 17 dhjetor 2014 i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë për Këshillin e Evropës "Mbi normat dhe parimet evropiane në lidhje me prokurorët", emërtuar "Karta e Romës", paragrafët 40-50;

- Opinion nr.13(2018) i CCPE: "Pavarësia, përgjegjshmëria dhe etika e prokurorëve", datë 23 nëntor 2018, paragrafët 39-43;

- Raport për pavarësinë dhe paanshmërinë e prokurorisë në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në vitin 2017, përgatitur nga Byroja e CCPE pas propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, datë 7 shkurt 2018, paragrafët 30-31;

- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Rolin e Prokurorëve të vitit 1990;

- Standartet e Përgjegjësisë Profesionale dhe Deklarata e Detyrave dhe të Drejtave Themelore të Prokurorëve 1999 të IAP (Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve);

- Udhëzimet Evropiane për Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve Publikë (Këshilli i Evropës, "Udhëzimet e Budapestit", 2005);

-Deklarata e Bordo-së e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (CCJE) dhe Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (CCPE) mbi "Gjyqtarët dhe Prokurorët në Shoqërinë Demokratike";

UDHËZOJ:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është për të unifikuar, të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në ushtrimin e funksioneve, marrëdhëniet e tij me drejtuesit e prokurorive, si prokurorë më të lartë dhe informimin e koordinimin në veprimtarinë e prokurorisë, për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, mbikëqyrjen, eficientë, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues i pavarur.

2. Ky udhëzim ka për qëllim, gjithashtu, për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin në praktikë të disa çështjeve ligjore që lidhen me respektimin e parimeve të ligjshmërisë², detyrueshmërinë e ndjekjes penale³ dhe pavarësisë⁴ në marrëdhëniet ndërmjet prokurorit me drejtuesit e prokurorive në të gjithë nivelet me juridiksion të përgjithshëm, në përjasje me standartet dhe praktikat e mira evropiane për unifikimin dhe përmirësimin e veprimtarisë organizative dhe funksionale apo procedurale në prokurori.

Neni 2

-Raporti "Sfidat për pavarësi dhe paanshmëri gjyqësore në Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës" përgatitur nga Byroja e CCJE dhe Byroja e CCPE për dijeninë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në vijim të raportit të tij të 2015 me titull "Demokracia, të Drejtat e Njeriut dhe Shteti i së Drejtës në Europë- përgjegjësi e përbashkët për sigurinë demokratike në Europë", paragrafët 118-119.

- Lista e Kontrollit Shteti të së Drejtës, paragrafët 91 dhe 92, miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 106^{te} (11-12 mars 2016).

- Raport për standartet evropiane në lidhje me pavarësinë e sistemit gjyqësor: pjesa II- Prokuroria. Miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën plenare të 85^{te} (17-20 dhjetor 2010), paragrafët 29-32 dhe 53-60

-Përmbledhje e opinioneve të Komisionit të Venecias mbi çështje të ndryshme që lidhen me aspaketet procedurale dhe administrative të prokurorisë mund të aksesohet këtu:

<https://eet.venice.coe.int/eetbforms/documents/?pdf=ÇDL-PI%282018%29001-e>

² Shih, nenin 4 "Ligjshmëria e veprimtarisë" të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", që parashikon:

"1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi.

2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik."

³ Shih, po aty, nenin 5 "Detyrueshmëria e ndjekjes penale", që parashikon: "Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe."

⁴ Shih, po aty, nenin 6 "Pavarësia e prokurorëve", që parashikon:

"1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitje kërkese dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

2. Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat."

Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

a) Garantimi i pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në ushtrimin e funksioneve procedurale në kryerjen e hetimeve, përfaqësimin e akuzës dhe/ose çështjes në gjyq dhe urdhërimin ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale në raport me detyrueshmërinë e ndjekjes penale dhe zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e prokurorisë.

b) Përcaktimi i raporteve apo marrëdhënieve administrative dhe funksionale ose procedurale penale, ndërmjet:

i) prokurorit me drejtuesin e seksionit, zëvendësdrejtuesin dhe drejtuesin e prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë saj.

ii) prokurorit të apelit me drejtuesin e prokurorisë pranë gjykatës së apelit për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë saj.

iii) prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorëve e drejtuesve të prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe pranë gjykatave të shkallës së parë, me Prokurorin e Përgjithshëm.

c) Mënyrat e informimit në të gjitha hallkat dhe nivelet e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, ndalimin e publikimit të akteve dhe ruajtjen e sekretit të hetimeve.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë udhëzim, termat apo emërtimet kanë kuptimet si më poshtë:

1. “Prokurori me juridiksion të përgjithshëm” janë prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe Prokuroria e Përgjithshme⁵.

2. “Prokuror” është magjistrati i emëruar prokuror sipas ligjit⁶ që ushtron funksionet në prokuroritë e të gjithë niveleve me juridiksion të përgjithshëm.

3. “Prokuror më i lartë” është⁷:

a. Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe për prokurorët e drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

b. Drejtuesi i prokurorisë së apelit pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë kësaj prokurorie.

c. Drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë kësaj prokurorie.

4. “Prokurori i Përgjithshëm” është drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka përgjegjësi për punën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe prokurori më i lartë për prokurorët në prokuroritë e të gjithë niveleve të këtij juridiksioni⁸.

⁵ Shih, po aty nenin 2 shkronja “d”.

⁶ Shih, nenet 35, 37, 39 pika 3 e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁷ Shih, nenin 2 shkronjat “c” paragrafët “i”, “ii”, “iii” të ligjit nr.97/2016.

⁸ Shih, nenin 2 shkronja “c” parag. “i” e “d”, nenin 38 pika 1 e vijues të ligjit nr.97/2016.

5. "Drejtuesi i prokurorisë", është titullari/drejtuesi i çdo prokurorie pranë gjykatave të apelit ose të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe prokurori më i lartë për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë prokurorisë që ai drejton⁹.

6. "Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë" është një nga drejtuesit e seksioneve në prokuroritë ku janë krijuar seksione ose një nga prokurorët në prokuroritë ku nuk ka seksione, që plotëson kushtet e kriteret ligjore¹⁰ dhe emërohet nga drejtuesi i prokurorisë, pasi merr mendimin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve, për një mandat 2 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

7. "Seksionet në prokurori" janë njësi të strukturës në prokuroritë përkatëse me jo më pak se tre prokurorë, të cilat ngrihet nga drejtuesi i prokurorisë për kategori të caktuara veprash penale, kur është e mundur dhe e nevojshme.¹¹

8. "Drejtuesi i seksionit" është prokurori i emëruar nga drejtuesi i prokurorisë nga radhët e seksionit, që ka të paktën 5 vjet përvojë dhe ka rezultate të mira në punë dhe aftësi organizative¹².

9. "Pavarësia e prokurorit" është pavarësia dhe autonomia e prokurorit për marrjen e vendimeve në kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale, përfaqësimin në gjyq të një çështje dhe/ose akuze penale dhe urdhërimin ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat apo palë në procesin penal.¹³

10. "Detyrueshmëria e ndjekjes penale" është detyrimi kushtetues dhe ligjor i prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit për çështjen që i ngarkohet dhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale, si dhe detyrimi në çdo rast të zbatojë udhëzimet e përgjithshme të prokurorit më të lartë të nxjerra me qëllim unifikimin e qëndrimit të prokurorisë për problematika të caktuara.¹⁴

11. "Ligjshmëria e veprimtarisë" është detyrimi i prokurorit që në ushtrimin e funksioneve ose detyrës t'i nënshtrohet, Kushtetutës, akteve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe legjislacionit të brendshëm në fuqi, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe duke mbrojtur liritë, të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, si dhe interesin e shtetit dhe atë publik¹⁵ në procesin penal.

KREU II GARANTIMI I PAVARËSISË SË PROKURORIT

Neni 4

Pavarësia e prokurorit, detyrueshmëria e ndjekjes penale dhe respektimi i ligjshmërisë të veprimtarisë në prokurori

⁹ Shih, nenin 2 shkronjat "b" dhe "c" parag. "ii, iii", nenin 42 e vijues të ligjit nr.97/2016.

¹⁰ Shih, nenin 44 të ligjit nr.97/2016 dhe urdhërin Nr.101 date 12.06.2019 "Per miratimin e Rregullores "Per emerimin e zevendesdrejtuesit te prokurorise ne prokurorite me juridiksion te pergjithshem".

¹¹ Shih, nenin 21, paragrafi 1 të ligjit nr.97/2016.

¹² Shih, po aty nenin 21, pika 2.

¹³ Shih, nenin 148 pika 2 të Kushtetutës, nenin 6 të ligjit nr.97/2016 dhe Relacioni datë 27.06.2016 shoqërues të projekligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" të Kuvendit të Shqipërisë dhe jurispondencën e GJEDNJ vendimet për çështjet: -Lešnik v. Slovakia, nr. 54, 11 mars 2003; -Błaja Neës sp. Z o.o. v. Poland, nr. 60, 23 nëntor 2013; -Çhernysheva v. Russia, 10 qershor 2004.

¹⁴ Shih, nenin 148 pika 1 e Kushtetutes, nenin 5, 24 e vijues të ligjit nr.97/2016 dhe Relacionin e Kuvendit të Shqipërisë datë 27.06.2016 shoqërues të projekligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" dhe jurispondencën e GJEDNJ vendimet për çështjet: -Lešnik v. Slovakia, nr. 54, 11 mars 2003; -Błaja Neës sp. Z o.o. v. Poland, nr. 60, 23 nëntor 2013; -Çhernysheva v. Russia, 10 qershor 2004.

¹⁵ Shih, nenin 4 të ligjit nr.97/2016 dhe nenin 1 e vijues të K.Pr.Pemale.

1. Prokurori ka pavarësi dhe autonomi në ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore për kryerjen e veprimeve procedurale, parashtrimin e kërkesave dhe marrjen e vendimeve në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm, i çdo autoriteti publik apo privat, gjatë hetimeve paraprake, përfaqësimit të akuzës dhe/ose çështjes në gjykatë dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale apo mbikëqyrjes së zbatimit tyre¹⁶.

2. Në ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur, prokurori duhet të bazohet në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtur liritë e të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve, interesin e shtetit dhe atë publik në procesin penal.

3. Pavarësia procedurale nuk e shmang prokurorin nga detyrimi për të përmbushur funksionet dhe/ose përgjegjësitë kushtetuese e ligjore që ka për të ushtruar ndjekje penale për çështjen që i ngarkohet dhe në çdo rast të ndjekë dhe zbatojë udhëzimet e përgjithshme të nxjerra nga prokurori më i lartë¹⁷, me qëllim unifikimin e qëndrimeve në veprimtarinë e prokurorisë për problematika të caktuara, përfshi dhe për zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave apo Rezolutave të Kuvendit për luftën kundër kriminalitetit.

Neni 5

Ankimi kundër udhëzimit të përgjithshëm

1. Prokurorët më të lartë mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme të arsyetuara me shkrim të natyrës administrative ose procedurale të cilët janë të detyrueshëm për prokurorët më të ulët¹⁸.

2. Prokurori, në rastet kur vlerëson se udhëzimi i përgjithshëm është i pabazuar në ligj, apo është haptazi në kundërshtim me ligjin, mund të bëjë ankim kundër udhëzimit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë¹⁹, duke ndjekur procedurën si më poshtë:

a) Ankimi i prokurorit kundër udhëzimit të përgjithshëm duhet të paraqitet në Këshillin e Lartë të Prokurorisë brenda 30 ditëve²⁰ nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen e udhëzimit.

b) Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mbledhjen plenare shqyrton ankimin kundër udhëzimit të përgjithshëm²¹ dhe vendos në zbatim të ligjit dhe dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative²².

¹⁶ Shih, po aty nenin 25 pika 2 "Ushtrimi i funksioneve të prokurorit" dhe neni 6 pika 1 e vijues të ligjit nr.97/2016;

¹⁷ Shih, po aty nenin 6, -Relacionin datë 27.06.2016 shoqërues i projekligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" për në Kuvendin e Shqipërisë dhe -jurisprudencën e GJEDNJ vendimet për çështjet: -Lešnik v. Slovakia, nr. 54, 11 mars 2003; -Błaja Neës sp. Z o.o. v. Poland, nr. 60, 23 nëntor 2013; -Çernysheva v. Russia, 10 qershor 2004.

¹⁸ Shih, nenet 38 pika 2 shkronja "b" e 46 të ligjit nr.97/2016.

¹⁹ Shih, po aty, nenin 47 pika 1;

²⁰ Shih, nenin 132 "Afati i ankimit administrative ndaj aktit administrative" të ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurës administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili në pikën 1 parashikon: "1. Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen...aktit administrativ".

²¹ Shih, neni 159 të ligji nr.115/2016 "Mbi organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", i cili në pikën 2 shkronja "f", parashikon: "Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ushtron kompetencat e mëposhtme:...f) shqyrton ankimet kundër udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm ose të drejtuesve të prokurorive".

²² Shih, po aty nenin 189 "Aktet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë", i cili në pikën 3 parashikon: "3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast apo situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj."

c) Kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit në lidhje me pajtueshmërinë e tij me ligjin²³, brenda 30 ditëve nga data kur është marrë njoftim për vendimin e Këshillit.

3. Prokurori është i detyruar të zbatojë udhëzimin e përgjithshëm të ankimuar prej tij²⁴, me përjashtim të rasteve kur ai vlerëson se udhëzimi është haptazi në kundërshtim me ligjin, siç mund të jenë në rastet kur:

- a) udhëzimi i përgjithshëm nuk është me shkrim dhe/ose është i pa arsyetuar;
- b) udhëzimi i përgjithshëm është për çështje konkrete;
- c) udhëzimi i përgjithshëm i drejtuesit të prokurorisë është haptazi në kundërshtim me udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm.

ç) udhëzimi i përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm është haptazi në kundërshtim me ligjin për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, ligjin procedural penal ose ligjin material penal.

4. Prokurori nuk mban përgjegjësi për ankimin dhe për moszbatimin e udhëzimit të përgjithshëm në rastet që parashikojnë shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” të pikës 3 të këtij neni.

5. Prokurori më i lartë, kërkon fillimin e inspektimit dhe/ose hetimit disiplinor ndaj prokurorit²⁵ në rastet kur ai nuk zbaton udhëzimet e përgjithshme dhe vepron haptazi në kundërshtim me ligjin apo vepron me keqdashje apo pakujdesi të rëndë në veprimtarinë procedurale të tij.

Neni 6

Qëndrimi i prokurorit ndaj ndërhyrjes ose ushtrimit të ndikimit të paligjshëm

1. Prokurori në çdo rast që evidenton ndërhyrje ose ushtrim ndikimi, të papërshtatshëm, apo në kundërshtim me ligjin ndaj tij, nga brenda sistemit të prokurorisë, apo nga përfaqësues të pushtetit legjislativ, ekzekutiv, medias apo çdo personi tjetër juridik a fizik apo subjekt i procedimit penal, menjëherë refuzon çdo ndërhyrje ose ushtrim ndikimi të paligjshëm²⁶, merr çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi dhe ushtron funksionet në zbatim të kushtetutës dhe ligjit.

2. Prokurori, në këto raste, kur janë kushtet dhe/ose kriteret ligjore, sipas rastit, menjëherë paraqet kallëzim penal dhe/ose kryhet arrestimi në flagrancë i personit që ushtron ndikim të paligjshëm, dhe njofton pa vonesë drejtuesin e prokurorisë, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe/ose Kryetarin e saj²⁷.

Neni 7

Qëndrueshmëria e organit të prokurorisë në raport me pavarësinë funksionale të prokurorit

1. Pavarësia funksionale e prokurorit në vendimmarrje për çështje konkrete, duhet të garantohet, duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë e organit të prokurorisë dhe uniformitetin

²³ Shih, po aty nenin 192 “Ankimi i vendimeve të Këshillit”, i cili në pikën 2 parashikon: “2. Aktet administrative me efekt të përgjithshëm detyruet i nënshtrohen kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe kontrollit të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me ligjin.”

²⁴ Shih, nenin 47 pika 2 e ligjit nr.97/2016;

²⁵ Shih, po aty, nenet 38 pika 2 shkronja “i” dhe 42 shkronja “dh” .

²⁶ Shih, nenin 3 pika 3 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

²⁷ Shih, po aty nenin 3 pika 3.

e veprimtarisë së tij, përmes nxjerrjes dhe zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme nga Prokurori i Përgjithshëm dhe/ose drejtuesit e prokurorisë, të cilët kujdesen për ushtrimin e kompetencave ligjore/kushtetuese në veprimtarinë e prokurorisë dhe kanë përgjegjësi ligjore për mbarëvajtjen e punës në prokurori, si dhe nxjerrin udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete për prokurorët e prokurorisë që drejtojnë.

2. Rregullat që disiplinojnë autoritetin e drejtuesve të prokurorisë si prokurorë më të lartë, në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe pavarësisë në ushtrimin e funksioneve të prokurorit, janë:

a) Respektimi i procedurës ligjore nga prokurori më i lartë për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme me shkrim dhe të arsyetuar:

i) për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit materjal penal e ligjit procedural penal në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës/çështjes në gjykim, ushtrimin e të drejtës së ankimit/rekursit nga prokurori dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale, bazuar në vendime gjyqësore njësuere ose unifikuese të Kolegjit Penal dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë²⁸;

ii) për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe Rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë për luftën kundër kriminalitetit²⁹, që përcaktojnë përparësitë për zbatimin e politikës penale dhe/ose mënyrat e ndjekjes së tyre.

iii) për përcaktimin e një tërësi kriteresh në zbatim të ligjit dhe unifikuar vendimmarrjen për çështje apo grup çështjesh ligjore të njëjta, që trajtohen ose kualifikohen ndryshe nga prokurorët në të njëjtën prokurori ose në prokurori të ndryshme me juridiksion të përgjithshëm.

b) Respektimi i procedurës ligjore nga drejtuesit e prokurorisë për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete për prokurorët në prokuroritë përkatëse, të cilët duhet që:

i) të jenë me shkrim dhe të arsyetuara, me përjashtim të rasteve kur rrethanat nuk lejojnë udhëzimet jepen verbalisht dhe brenda dy ditësh duhet të konfirmohen me shkrim.

ii) në rastet kur prokurori ka kërkuar shpjegime për udhëzimin jo të detyrueshem, pasi nuk është dakort apo ka paqartësi në lidhje me të, drejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit përkatës të japë shpjegime mbi udhëzimet jo të detyrueshme dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë, ndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr.

c) Respektimi i të drejtës që prokurori ka sipas ligjit për heqjen dorë nga çështja konkrete që ka në ndjekje dhe kryerja e procedurës për zëvendësimin e tij³⁰.

KREU III

MARRËDHËNIET NDËRMJET PROKURORIT ME DREJTUESIT NË PROKURORI

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në marrëdhënie me drejtuesit në prokurori

1. Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në marrëdhëniet administrative me drejtuesit e prokurorisë janë:

a) Prokurori merr pjesë në çdo mbledhje të thirrur nga prokurori më i lartë³¹ përveç rasteve të justifikuara sipas ligjit apo me akte normative përkatëse.

²⁸ Shih, nenin 46 pika 3 shkronja "b" të ligjit nr.97/2016 dhe nenin 438 të K.Pr.Penale;

²⁹ Shih, po aty nenin 46 pika 3 shkronja "c" në lidhje me nenin 104 pika 2 shkronja "b";

³⁰ Shih, nenin 26 në lidhje me nenin 17 dhe nenin 27 të K.Pr.Penale dhe nenin 49 të ligjit nr.97/2016.

³¹ Shih nenin 2 shkronja "c" të ligjit nr.97/2016.

- b) Prokurori zbaton kushtet dhe kriteret e përcaktuar sipas ligjit dhe/ose me udhëzim të përgjithshëm për pjesëmarrjen në short apo për marrjen e një dosje/çështje që i është caktuar.
- c) Prokurori merr pjesë në çdo diskutim të natyrës profesionale të thirrur nga drejtuesi i prokurorisë dhe është pjesë konstruktive e këtyre diskutimeve.
- ç) Prokurori duhet të respektojë orarin zyrtar dhe të gjitha detyrimet administrative të parashikuara në ligj dhe me aktet normative detyruese përkatëse.
- d) Prokurori informon drejtuesin e prokurorisë për çdo veprimtari jashtë funksionit të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas ligjit.
- dh) Prokurori ndihmon organet administrative të prokurorisë kur i kërkohet brenda kompetencave dhe funksionit të tij.

2. Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në marrëdhëniet procedurale me drejtuesit e prokurorisë janë:

- a) Prokurori udhëhiqet nga pavarësia e tij procedurale në kryerjen apo kontrollin e hetimeve, ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit, ushtrimin e të drejtës së ankimit, urdhërimin dhe/ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale apo kryerjen e detyrave të tjera të caktuara me ligj.³²
- b) Prokurori në ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur ka detyrimin të respektojë Kushtetutën, kuadrin ligjor të veprimtarisë, udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe/ose të drejtuesit të prokurorisë ku ai është emëruar apo ushtron funksionet³³.
- c) Prokurori ka detyrimin të informojnë drejtuesin e prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me ecurinë e procedimeve/çështjeve të caktuara dhe vendimmarrjen, si dhe, në raste të veçanta, për problematika që shfaqen në ecurinë e procedimit³⁴.
- ç) Prokurori duhet të shmangë çfarë do lloj ndikimi dhe sjellje të paligjshme e të papërshtatshme që cënon drejtësinë dhe imazhin e prokurorisë.³⁵
- d) Çdo marrëdhënie që lidhet me çështjen apo funksionet e tij si prokuror duhet të ushtrohet prej tij në rrugë institucionale.
- dh) Prokurori njofton drejtuesin e prokurorisë në rastet që konstaton se ka papajtueshmëri apo konflikt interesi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me çështjen konkrete që ka në ndjekje apo në shqyrtim gjyqësor.³⁶
- e) Prokurori duhet të marrë pjesë në grupet e përbashkëta hetimore ose në procedime të lidhura në zbatim të ligjit dhe/ose planifikimit të bërë nga drejtuesi i prokurorisë.³⁷
- ë) Prokurori, për çdo takim në funksion të procedimit/çështjes konkrete që ka në ndjekje të kryer jashtë institucionit edhe në mënyrë informale, njofton dhe merr miratimin paraprak të drejtuesit të prokurorisë.

3. Detyrime etike të prokurorit në marrëdhëniet me drejtuesit e prokurorisë janë:

³² Shih, nenin 148 pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 24 e vijues të K.Pr.Penale.

³³ Shih, po aty nenin 148/b pika 2 shkronja "b", nenin 38 pika 2 shkronja "b" e 46 të ligjit nr.97/2016;

³⁴ Shih, nenin 52 pika 2 në lidhje me nenet 43 shkronjat "b" e "ç" dhe 48 pika 5 të ligjit nr.97/2016;

³⁵ Shih, nenin 3 të ligjit nr.96/2016.

³⁶ Shih, neni 51 të ligjit nr.97/2016 në lidhje me nenin 3 pikat 1,4 e nenet 4, 5 e vijues të ligjin nr.9367/2005 "Për parandalimin e konfliktin të interesit në ushtrimin e funksioneve."

³⁷ Shih, nenin 42 shkronja ç" të ligjit nr.97/2016 në lidhje me nenin 306 të K.Pr.Penale.

a) Prokurorët duhet të ruajnë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre dhe të sillen në mënyrë profesionale me drejtuesit në prokuroritë e të gjithë niveleve, në përputhje me ligjin dhe/ose rregullat e etikës³⁸.

b) Respekti ndaj prokurorit më të lartë përbën një ndër normat kryesore etike, e cila lidhet me respektin ndaj ligjit dhe institucionit të prokurorisë.

c) Prokurori duhet të respektojë etikën dhe ligjin gjatë komunikimit në marrëdhënie me prokurorin më të lartë.

Neni 9

Kompetencat dhe roli i drejtuesit në prokurori në marrëdhënie me prokurorët

1. Drejtuesi i prokurorisë në të gjitha nivelet e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm është përgjegjës për krijimin e kushteve që bëjnë të mundur organizimin e punës, respektimin e ligjit, etikës dhe mirëfunksionimin e prokurorisë³⁹ dhe për mbarëvajtjen e punës dhe sigurimin e efikasitetit, efikasitetit, ligjshmërisë dhe transparencës në veprimtarinë e prokurorisë⁴⁰ që drejton.

2. Kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm në marrëdhënie me prokurorët e drejtuesit e prokurorive janë:

a) Është drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka përgjegjësi për veprimtarinë e saj dhe të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm⁴¹.

b) Përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese⁴² në kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm.

c) Nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe mbikëqyr zbatimin e tyre⁴³.

ç) Kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë⁴⁴.

d) Përfaqëson prokurorinë në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështje penale të juridiksionit të përgjithshëm⁴⁵.

dh) Përcakton strukturën e përgjithshme dhe rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm⁴⁶.

e) Miraton organikën dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas përcaktimeve në ligj⁴⁷.

ë) Propozon dhe administron buxhetin e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm⁴⁸.

f) Merr periodikisht të dhëna dhe informacione nga prokuroritë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së tyre⁴⁹.

³⁸ Shih, nenin 10 të ligjit nr.97/2016.

³⁹ Shih po aty, shkronjën "a" të nenit 42.

⁴⁰ Shih, po aty nenin 52 .

⁴¹ Shih, po aty nenin 38 pika 1.

⁴² Shih, nenin 148/b shkronja "a" te Kushtetutës dhe nenin 38 pika 2 shkronja "a" të ligjit nr.97/2016.

⁴³ Shih, po aty nenin 148/b shkronja "b" dhe nenin 38 pika 2 shkronja "b" në lidhje me nenin 46.

⁴⁴ Shih, nenin 38 pika 2 shkronja "f" të ligjit nr.97/2016.

⁴⁵ Shih, po aty nenin 38 pika 2 shkronja "e".

⁴⁶ Shih, po aty nenin 38 pika 2 shkronja "e".

⁴⁷ Shih, po aty nenin 38 pika 2 shkronja "e" në lidhje me nenin 20.

⁴⁸ Shih, nenin 148/b shkronja "ç" të Kushtetutës dhe nenin 38 pika 2 shkronja "c" të ligjit nr.97/2016.

⁴⁹ Shih, nenin 50 pika 1 të ligjit nr.97/2016.

g) Raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit⁵⁰.

3. Kompetencat dhe roli i drejtuesit të prokurorisë në marrëdhënie me prokurorët e prokurorisë që drejton janë:

a) Miraton rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, duke përshtatur strukturën me rregulloren standarte të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, sipas veçorive, ngarkesës së punës, nevojave specifike të prokurorisë që drejton dhe specializimin e prokurorëve.

b) Nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim, të detyrueshme për prokurorët, të natyrës organizative dhe procedurale apo funksionimit të prokurorisë që drejton⁵¹, për lehtësimin dhe garantimin e zbatimit korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm⁵².

c) Mbikëqyr disiplinën në punë dhe respektimin e etikës së prokurorit⁵³, jep mendim për vlerësimin profesional të prokurorit⁵⁴ dhe mund të kërkojë fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore⁵⁵.

ç) Mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e veprimeve administrative të administratës së prokurorisë në ndihmë të prokurorit për veprimtarinë e tij.⁵⁶

d) Informon çdo tre muaj mbi gjendjen e kriminalitetit Prokurorin e Përgjithshëm.⁵⁷

dh) Paraqet raportin vjetor tek Prokurori Përgjithshëm për ecurinë e punës në prokurori, zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve të Këshillit Ministrave dhe/ose, udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.⁵⁸

3.1 Kompetencat organizative të drejtuesit të prokurorisë në marrëdhënie me prokurorët e prokurorisë që drejton janë:

a) Organizon shpërndarjen e çështjeve prokurorëve⁵⁹, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse të miratuara nga prokurori më i lartë⁶⁰.

b) Krijon grupe hetimore për çështje të veçanta dhe/ose komplekse⁶¹.

3.2. Kompetencat e drejtuesit të prokurorisë në marrëdhënie me prokurorin lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale janë:

a) Koordinon veprimtarinë e prokurorit të çështjes me prokuroritë e tjera për procedime/çështje konkrete⁶²;

b) I kërkon informacion prokurorit për ecurinë e procedimeve⁶³ dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime jo të detyrueshme me shkrim⁶⁴.

⁵⁰ Shih, nenin 148/b shkronja “d” të Kushtetutes dhe nenin 38 pika 2 shkronja “d” në lidhje me nenin 104 te ligjit nr.97/2016.

⁵¹ Shih po aty, neni 42, shkronja “j”.

⁵² Shih po aty, nenin 42 shkronja “g” në lidhje me nenin 46 pika 4 dhe nenin 43 shkronja “dh”.

⁵³ Shih po aty, neni 42, shkronjat “dh” dhe “k”.

⁵⁴ Shih, nenin 87 të ligjit nr. 96/2016.

⁵⁵ Shih po aty, neni 119 pika 2 shkronja “c”.

⁵⁶ Shih, nenin 42 shkronja “f” të ligjit nr. 97/2016.

⁵⁷ Shih po aty, neni 42, pika “l”.

⁵⁸ Shih po aty neni 50.

⁵⁹ Shih po aty, neni 42, shkronjat “c”.

⁶⁰ Shih po aty neni 53 dhe udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.3 date 29.03.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

⁶¹ Shih neni 42 shkronja “ç” të ligjit nr.97/2016.

⁶² Shih po aty nenin 43 shkronja “a” .

⁶³ Shih po aty shkronja “b” e nenit 43.

⁶⁴ Shih po aty, pika 3 e nenit 48.

- i) në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje prokurorit⁶⁵;
- ii) kur e vlerëson të nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit⁶⁶.
- c) Verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve, dhe kur është e nevojshme, nxjerr udhëzime jo të detyrueshme me shkrim, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake⁶⁷.
- ç) Vlerëson dhe vendosë mbi kërkesën e prokurorit për heqjen dorë për shkaqe papajtueshmërie⁶⁸, për arsye njëanshmërie⁶⁹ apo për shmangien e konfliktit të interesit për rastet e parashikuara në ligj.⁷⁰
- d) Vlerëson dhe vendosë zëvendësimin e prokurorit, kur ka arsye serioze që lidhen me detyrën dhe/ose në rastet e parashikuara në ligj⁷¹.

Neni 10

Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre

1. Prokurori i Përgjithshëm si prokuror më i lartë⁷² nxjerr udhëzime të përgjithshme të detyrueshme të natyrës administrative e procedurale penale dhe kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorëve⁷³ në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të prokurorëve në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

2. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe pranë gjykatave të shkallës së parë garantojnë zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm⁷⁴, duke nxjerrë udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e tyre, si dhe mbikëqyrin zbatimin e tyre prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive, informojnë periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm me të dhëna të sakta mbi gjendjen e kriminalitetit dhe/ose për ecurinë e veprimtarisë në prokuroritë që drejtojnë, si dhe përgatisin e dërgojnë raportin vjetor në formën dhe sipas indikatorëve të përcaktuar, raport i cili miratohet me urdhër të tij⁷⁵.

4. Prokurori i Përgjithshëm nxjerr udhëzime të përgjithshme, edhe për zbatimin e rekomandimeve periodike të Këshilli i Ministrave⁷⁶ dhe Rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë.

a) Me zbatimin e tyre ngarkohen prokurorët dhe drejtuesit e prokurorive, të cilët raportojnë si kanë ndikuar ato mbi gjendjen e kriminalitetit dhe në veprimtarinë e prokurorisë në fushat e rekomanduara.

b) Për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre raportojnë si drejtuesit e prokurorive, ashtu dhe prokurorët dhe punonjësit e strukturave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët

⁶⁵ Shih po aty, pika 3 e nenit 48.

⁶⁶ Shih po aty, pika 3 e nenit 48.

⁶⁷ Shih po aty, shkronja “ç” e nenit 43.

⁶⁸ Shih nenin 26 në lidhje me nenin 16 të K.Pr.Penale.

⁶⁹ Shih po aty nenin 26 në lidhje me nenin 17.

⁷⁰ Shih nenin 26 të K.Pr.Penale dhe nenin 51 të ligjit nr.97/2016 në lidhje me ligjin nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

⁷¹ Shih nenin 27 të K.Pr.Penale dhe nenin 49 të ligjit nr.97/2016.

⁷² Shih nenin 2 shkronja “c” e ligjit nr. 97/2016.

⁷³ Shih po aty nenin 38 shkronja “f”.

⁷⁴ Shih po aty nenin 42 shkronja “g” dhe nenin 43 shkronja “dh”.

⁷⁵ Shih po aty nenin 50.

⁷⁶ Shih po aty nenin 46 pika 3 shkronja “c”.

informojnë Prokurorin e Përgjithshëm dhe përgatisin projekt informimin dhe/ose raportimin e tij përpara Kuvendit⁷⁷, bazuar në të dhënat e dërguara të sakta e të detajuara lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe me elemente apo indikatorë të tjerë thelbësore në veprimtarinë e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Neni 11

Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzime jo të detyrueshme për prokurorët dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre

1. Udhëzime jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve procedurale përpara se të merret vendimi për mënyrën e përfundimit të procedimit/çështjes konkrete⁷⁸ mund të jepen/nxirren nga:

- a) Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme;
- b) Drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së apelit për prokurorët e prokurorisë që drejton;
- c) Drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës të shkallës së parë për prokurorët e prokurorisë që drejton, ose;
- ç) Drejtuesi i seksionit për prokurorët e caktuar në seksionin që ai drejton.

2. Udhëzimet mund të nxirren nga drejtuesi përkatës, në momentin e caktimit, të kallëzimit penal apo referimit të veprës penale dhe/ose të procedimit/çështjes për ndjekje prokurorit, ose gjatë procesit të verifikimit të ecurisë së procedimit/çështjes, kur drejtuesi e vlerëson të nevojshëm për mbarëvajtjen apo mënyrën e përfundimit të procedimit/çështjes⁷⁹.

- a) Udhëzimet duhet të jepen me shkrim dhe të arsyetuara.
- b) Përrjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe brenda 48 orëve të konfirmohen me shkrim.

3. Në rastet, kur prokurori i udhëzuar nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me udhëzimet e dhëna, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme për udhëzimet ose për pjesë të tyre.

a) Në këto raste, drejtuesi përkatës është i detyruar të japë shpjegime mbi udhëzimet dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë, përndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr⁸⁰.

4. Në rastet kur prokurori, ndaj të cilit është përsëritur udhëzimi me shkrim, vendos të mos e zbatojë udhëzimin e drejtuesit, ai duhet të njoftojë me shkrim drejtuesin përkatës, duke arsyetuar shkaqet e mos zbatimit të udhëzimit prej tij.

a) Në këto raste, drejtuesi që ka nxjerrë udhëzimet jo të detyrueshme për prokurorin, nëpërmjet informacioneve për ecurinë e procedimit që merr nga prokurori, vlerëson gjendjen e ligjshmërisë dhe detyrueshmërinë e ushtrimit të ndjekjes penale në atë procedim penal dhe sipas rastit merr masat e duhura administrative dhe/ose procedurale.

5. Udhëzimi me shkrim dhe përgjigjet e prokurorit i bashkëlidhen akteve të procedimit penal.

KREU IV

MËNYRA E INFORMIMIT TË DREJTUESVE NË PROKURORI

Neni 12

Informimi i drejtuesve të prokurorisë nga prokurori

⁷⁷ Shih po aty nenin 104.

⁷⁸ Shih po aty, shkronja "ç" e nenit 43 dhe piken 1 të nenit 48.

⁷⁹ Shih po aty, piken 3 të nenit 48 në lidhje me shkronjën "ç" të nenit 43.

⁸⁰ Shih nenin 48 pika 5 te ligjit nr. 97/2016.

1. Prokurori i gatshëm duhet të informojnë drejtuesin e prokurorisë me marrjen e njoftimit për kryerjen e një vepër penale (ngjarje kriminale, referime të policisë gjyqësore ose kallëzime apo ankime penale), për arrestime në flagrancë apo ndalime dhe/ose për kryerjen e veprimeve procedurale (caktim mase sigurimi personal ose pasuror apo disponime të tjera në fazën e hetimeve paraprake) të kërkuara nga prokurori dhe të vendosura nga gjykata.

2. Njoftimi përmban elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri në atë kohë.

3. Njoftimi bëhet menjëherë verbalisht ose me anë të mjeteve të komunikimit telefonik apo elektronik, duke u siguruar për ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetin e të dhënave hetimore.

4. Prokurori informon drejtuesin e prokurorisë, sipas kërkesës së tij⁸¹, mbi ecurinë dhe problematikën e veprimeve të para hetimore dhe/ose mbi ecurinë e ushtrimit të ndjekjes penale të çështjes në hetim dhe në gjykim.

5. Drejtuesi i prokurorisë njoftohet paraprakisht nga prokurori në çdo rast kur ai vendos të mos procedojë personalisht dhe/ose të delegojë kryerjen e veprimeve të veçanta, në një rreth tjetër apo një prokurori të atij rrethi sipas kompetencës lëndore⁸² apo shkaqe të tjera ligjore.

6. Prokurori informon paraprakisht drejtuesin e prokurorisë rreth vendimit të tij për ngritjen e akuzës apo pushimin e saj kur procedohet për krime dhe/ose kundërvajtje penale.⁸³

7. Në rastet kur gjykata i kthen aktet prokurorit⁸⁴, prokurori duhet të njoftojë drejtuesin e prokurorisë brenda 24 orëve.

8. Prokurori duhet të njoftojë paraprakisht drejtuesin e prokurorisë në rastet kur administrohen prova lidhur me rrethana që lehtësojnë pozitën e të pandehurve dhe/ose personave nën hetim.

9. Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë apo drejtuesi i seksionit, që janë të gatshëm sipas grafikut të gatishmërisë, duhet të njoftojnë drejtuesin e prokurorisë për çdo kërkesë drejtuar gjykatës lidhur me arrestimet në flagrancë, ndalimet, masat e sigurimit personal dhe/ose pasuror, mjetet për kërkimin e provës, sigurimin e provës, për aktet drejtuar insitucioneve të vuajtjes së dënimit me burgim, masat mjekësore apo shërbimeve policore, të cilat nënshkruhen nga zëvendësdrejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit, në mungesë të drejtuesit të prokurorisë.

Neni 13

Informimi mbi masat e sigurimit personal dhe pasuror

1. Prokurorët që kanë në hetim, ose gjykim procedime penale duhet të njoftojnë paraprakisht, drejtuesin e prokurorisë, ose zëvendës drejtuesin apo drejtuesin e seksionit, sipas organizimit të brendshëm në prokurori, për urdhrat e ndalimit ose kërkesat drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit personal ose pasuror, mjetet për kërkimin e provës apo sigurimit të provës.

2. Prokurorët duhet të njoftojnë paraprakisht drejtuesin e prokurorisë, si për kërkesat e prokurorit, ashtu dhe për kërkesat e personit nën hetim, të pandehurit apo mbrojtësit të tij drejtuar gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ose kur ka ankim apo kërkesa nga të interesuarit për heqjen e sekuestrove.

⁸¹ Shih po aty nenin 43 pika 2.

⁸² Shih, nenet 304 pika 3, 28, 29 e 75/a të K.Pr.Penale.

⁸³ Shih po aty nenet 327/6, 328 dhe 329/a.

⁸⁴ Shih po aty nenet 329 pika 3, 329/b pika 3, 332/ç, 332/2, 332/dh shkronja "ç", 402 pika 4.

3. Prokurorët që kanë në hetim procedime penale ndaj personave nën hetim me masë sigurimi “arrest në burg” duhet të njoftojnë paraprakisht drejtuesin e prokurorisë çdo dy muaj për ecurinë dhe/ose progresin në rritje ose në ulje të kushteve dhe kritereve përkatëse lidhur me këto masa.

a) Njoftimi duhet të përmbajë veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe/ose personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra, si dhe veprimet hetimore, që priten të kryhen.

b) Në rastet e zbatimit të vendimit të arrestit, njoftimi bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë edhe informacionin drejtuar gjykatës në zbatim të dispozitave të K.Pr.Penale⁸⁵.

4. Prokurorët që kanë në hetim procedime penale, për të cilat ndaj personit nën hetim është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” ose “sekuestro preventive” apo “sekuestro konservative”, duhet të njoftojnë drejtuesin e prokurorisë, 10 ditë përpara përfundimit të afateve të paraburgimit apo të afatit të sekuestros që mund të ketë vendosur gjykata.

a) Njoftimi bëhet me shkrim, i cili duhet të përmbajë veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit ose të personit nën hetim dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra, si dhe veprimet hetimore, që priten të kryhen dhe shkaqet e zvarritjes së procesit gjyqësor.

Neni 14

Informimi për ecurinë e ushtrimit të ndjekjes penale

1. Prokurorët që kanë në hetim procedime penale, për të cilat është shënuar në regjistër emri i personave që u atribuohet vepra penale, duhet të njoftojnë drejtuesin e prokurorisë 10 (dhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit të hetimeve.

a) Njoftimi duhet të përmbajë veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, gjendjen e procedimit, përshkrimin e të dhënave të marra, si dhe veprimet hetimore, që duhet të kryhen dhe arsyet apo nëse ka, shkaqet e zgjatjes të afatit hetimor.

2. Prokurorët që kanë në hetim procedime penale, kur çmojnë se kanë përfunduar veprimet hetimore duhet të njoftojnë drejtuesin e prokurorisë 5 (pesë) ditë përpara përpilimit të aktit procedural të njoftimit për mënyrën e përfundimit të hetimeve.

a) Njoftimi bëhet me shkrim, i cili duhet të përmbajë veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, si dhe vlerësimin për vendimmarrjen eventuale (përpilimit të kërkesës për pushimin e akuzës ose çështjes apo të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq).

Neni 15

Informimi për përfaqësimin e akuzës në gjyq

1. Prokurorët që përfaqësojnë akuzën në gjyq ndaj të pandehurit/ve me masë sigurimi “arrest në burg”, duhet të njoftojnë apo informojnë drejtuesin e prokurorisë 10 ditë përpara përfundimit të afatit të paraburgimit të tij.

a) Njoftimi ose informimi bëhet me shkrim, i cili duhet të përmbajë gjendjen e gjykimit, provat e administruara, si dhe nëse ka, shkaqet e zvarritjes së procesit gjyqësor.

⁸⁵ Shih, nenin 246 pika 6 të K.Pr.Penale dhe vendimin unifikues nr.1/2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

2. Prokurorët që përfaqësojnë akuzën në gjykim duhet të njoftojnë drejtuesin e prokurorisë 2 (dy) ditë përpara dhënies së konkluzioneve përfundimtare, në rastet kur prokurori çmon se nuk mund t'i japë në të njëjtën seancë, në të cilën është zhvilluar shqyrtimi gjyqësor.

a) Njoftimi ose informimi bëhet me shkrim, i cili duhet të përmbajë përshkrimin e faktit penal që rezulton nga provat e administruara, deklarin e fajësisë, kualifikimin ligjor, llojin dhe masën e dënimit, që prokurori vlerëson të kërkojë.

3. Në rastet kur prokurori çmon se konkluzionet mund t'i japë në të njëjtën seancë, në të cilën është zhvilluar shqyrtimi gjyqësor, ai duhet të njoftojë drejtuesin e prokurorisë brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e vendimit.

4. Në rastet kur gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit lidhur me deklarin e fajësisë, cilësimin juridik të veprës, caktimin e llojit dhe/ose masës së dënimit apo caktimin e masës së sigurimit personal apo pasuror etj., prokurori menjëherë ose jo më vonë se brenda 2 (dy) ditëve informon drejtuesin e prokurorisë nëse do të ushtrojë apelim kundër vendimit të gjykatës.

5. Prokurori që ka ushtuar apelim kundër vendimit të gjykatës⁸⁶, në rastet kur pas shqyrtimit gjyqësor janë zbuluar prova ose rrethana të reja që i shërbejnë rigjyimit të çështjes së ankimuar, duhet të njoftojë drejtuesin e prokurorisë ku ushtron funksionin dhe sipas rastit përgatit shtesë ankimi, si dhe njofton prokurorin dhe/ose drejtuesin e prokurorisë pranë gjykatës që shqyrton ankimin.

Neni 16

Delegimi i kompetencave dhe informimi i zëvendës drejtuesit në prokurori

1. Drejtuesi i prokurorisë njofton paraprakisht Prokurorin e Përgjithshëm për periudhën kohore të delegimit të kompetencave të tij zëvendës drejtuesit, duke venë në dijeni dhe prokurorët në atë prokurori.

2. Në mungesë të drejtuesit të prokurorisë, prokurori është i detyruar t'i përgjigjet kërkesave të zëvendës drejtuesit të parashikuara në nenet 12, 13, 14 dhe 15 të këtij udhëzimi të përgjithshëm.

Neni 17

Informimi i drejtuesit të seksionit

1. Prokurori informon drejtuesin e seksionit⁸⁷ brenda kompetencave që i janë caktuar nga drejtuesi i prokurorisë.

2. Prokurori merr pjesë dhe kontribuon në çdo mbledhje apo analizë të veprimtarisë së seksionit.

⁸⁶ Koment: Arsyet dhe shkaqet e shtesës së apelimit kundër vendimit gjyqësor mund të jenë, si në gjykimin e themelit rastet kur i pandehuri për mungesë provash: -është deklaruar i pafajshëm (p.sh. për mungesë të një prove të kerkuar autoriteteve gjyqësore të huaja apo të provave të reja që kanë dalë pas shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë, etj) ose -i është ndryshuar cilësimi juridik i veprës penale (p.sh. për mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që provon se bashkëpandehuri në një procedim të lidhur është deklaruar fajtor dhe dënuar për kryerjen e të njëjtës veprë penale në rrethana të cilasuara, etj) apo -i është caktuar një lloj a masë dënimi më e butë (p.sh. për mungesë të dëshmisë së penaltetit që provon se është dënuar pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë, rrethane rënduese sipas neni 50 shkronja "ç" K.Penal, etj), ashtu dhe në gjykimin e masave të sigurimit ë rastet kur ka progres në rritje ose në ulje të kushteve dhe kriterëve ligjore lidhur me masat e sigurimit të ankimuar, sipas përcaktimeve në nenin 246 pika 6 dhe vendimin unifikues nr.1/2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁸⁷ Shih, nenin 12 pika 2 të ligjit nr. 97/2016.

3. Prokurori ka të drejtë të ankohet tek drejtuesi i prokurorisë në çdo rast që kërkesën apo veprimin e drejtuesit të seksionit e çmon si tejkalim kompetencash. Drejtuesi i prokurorisë vendos për zgjidhjen e mosmarrvëshjes, si dhe njofton prokurorin dhe drejtuesin e seksionit.

Neni 18

Informimi për përfaqësimin e çështjes në gjykatën e apelit

1. Prokurori i apelit që përfaqëson çështjen ose akuzën me ankim në gjykatën e apelit ndaj të pandehurit me masë sigurimi “arrest në burg”, duhet të njoftojë apo informojë drejtuesin e prokurorisë 7 (shtatë) ditë përpara përfundimit të afatit të paraburgimit të tij.

a) Njoftimi ose informimi bëhet me shkrim, i cili duhet të përmbajë gjendjen e gjyqimit, provat e administruara dhe nëse ka, shkaqet e zvarritjes së procesit gjyqësor.

2. Prokurori i apelit që përfaqëson çështjen ose akuzën në gjykim duhet njoftojë apo informojë drejtuesin e prokurorisë 2 (dy) ditë pas dhënies së konkluzioneve përfundimtare, në rastet kur prokurori çmon se nuk mund t'i japë në të njëjtën seancë, në të cilën është zhvilluar shqyrtimi gjyqësor.

a) Njoftimi ose informimi bëhet me shkrim, i cili duhet të përmbajë përshkrimin e faktit penal që rezulton nga provat e administruara, deklarimin e fajësisë, kualifikimin ligjor, llojin dhe masën e dënimit, që prokurori i apelit vlerëson të kërkojë.

3. Në rastet kur prokurori i apelit çmon se konkluzionet mund t'i japë në të njëjtën seancë, në të cilën është zhvilluar shqyrtimi gjyqësor, ai duhet të njoftojë drejtuesin e prokurorisë brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e vendimit.

4. Në rastet kur gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit të apelit lidhur me fajësinë, cilësimin juridik të veprës, llojin dhe/ose masën e dënimit, prokurori menjëherë ose jo më vonë se brenda 2 (dy) ditëve informon drejtuesin e prokurorisë të apelit nëse do të ushtrojë rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit.

5. Prokurori i apelit që ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës, në rastet kur pas shqyrtimit gjyqësor ka marrë dijeni kryesisht ose nga prokurori i çështjes për rrethana të reja që i shërbejnë rigjyqimit të çështjes së rekursuar, duhet të njoftojë drejtuesin e prokurorisë së apelit dhe sipas rastit mund të përgatitë shtesë rekursi, si dhe njofton prokurorin dhe/ose drejtuesin e prokurorisë pranë Gjykatës së Lartë.

Neni 19

Informimi për përfaqësimin e çështjes në Gjykatën e Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese

Prokurori në Prokurorinë e Përgjithshme që përfaqëson akuzën dhe/ose çështjen me rekurs në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë apo që përfaqëson Prokurorinë e Përgjithshme në gjykimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm, informon për secilën çështje dhe në vazhdimësi Prokurorin e Përgjithshëm, për natyrën dhe problematikën e çështjeve që shqyrtohen në Gjykatën e Lartë ose Gjykatën Kushtetuese dhe për shkeljet e ligjit penal dhe/ose ligjit procedural penal në ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq të evidentuara në përfaqësimin e çështjeve nga prokurorët e prokurorive të shkallës së parë dhe të prokurorive të apeleve me juridiksion të përgjithshëm.

KREU V

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 20
Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbën vepër penale, përbën shkelje disiplinore sipas ligjit⁸⁸ dhe shkak për të kërkuar fillimin e inspektimit dhe/ose hetimin disiplinor ndaj prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Neni 21
Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët dhe drejtuesit e prokurorive të gjithë niveleve të juridiksionit të përgjithshëm⁸⁹.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm⁹⁰ dhe prokurorët e drejtuesit në strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm⁹¹.

Neni 22
Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU



⁸⁸ Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës dhe nenet 101 pika 1 shkronja “a” “b” dhe 102 pika 1 shkronjat “c” “ç”, “d” “dh”, “e”, “g”, “j”, “nj”; pika 2 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit nr.96/2016.

⁸⁹ Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 6 pika 2 të ligjit nr.97/2016

⁹⁰ Shih po aty nenin 43 shkronja “dh”.

⁹¹ Shih po aty nenet 46 pika 4.